



AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Dobësi të shumta kritike në HP Device Manager

Data: 10/03/2026
Version: 1.0

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	1
Informacione Teknike	1
Rekomandime	2
Referenca	2

Përmbledhje Ekzekutive

HP Device Manager (HPDM) përmban disa dobësi sigurie që mund të lejojnë aktorë keqdashës të komprometojnë sistemet e prekura.

Informacione Teknike

Versionet e HP Device Manager (HPDM) para versionit 5.0.16 përmbajnë disa dobësi sigurie që mund të lejojnë aktorët keqdashës të komprometojnë sistemet e prekura. Këto dobësi burojnë nga disa komponentë të integruar dhe biblioteka të palëve të treta të përdorura brenda platformës.

Shfrytëzimi i suksesshëm i këtyre dobësive mund të mundësojë:

- ekzekutim të kodit në distancë (Remote Code Execution),
- përshkallëzim privilegjesh,
- ndërprerje shërbimi (DoS),
- zbulim të informacionit të ndjeshëm.

Disa nga dobësitë e identifikuar kanë rezultate **CVSS deri në 9.8 (Critical)**, çka tregon një probabilitet të lartë shfrytëzimi në mjediset e cenushme.

Dobësitë kryesore të identifikuar

Dobësi Kritike

CVE-2023-38545 – (CVSS 9.8)

Komponenti: cURL

CVE-2025-55754 – (CVSS 9.6)

Komponenti: Apache Tomcat

CVE-2025-23048 – (CVSS 9.1)

Komponenti: Apache HTTP Server

Produkti i prekur:

HP Device Manager

Versionet e prekura:

Të gjitha versionet para **5.0.16**

Versioni i korrigjuar:
HP Device Manager 5.0.16

Rekomandime

AKSK rekomandon të përditësoni **HP Device Manager** në versionin e korrigjuar ose në një version më të ri.

Referenca

https://support.hp.com/nz-en/document/ish_14442335-14442364-16/hpsbhf04092